

Neni 21/3 Sektori i Pyjeve Kullotave dhe Ruajtja e Mjedisit

- Është përgjegjës për administrimin e çdo çështje që lidh hartimin e politikave dhe planeve për mbrojtjen ,zhvillimin dhe shfrytëzimin e kontrolluar të fondit pyjor e kullosor në Bashkinë Pogradec
- Merr pjesë në organizimin dhe implementimin e planeve operacionale të mbarështimit të pyjeve dhe kullotave
- Punon për hartimin e planeve dhe projekteve për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve dhe kullotave
- Zbaton me përpikmëri planin e mbarështimit të fondit pyjor dhe kullosor brenda territorit
- Bashkëpunon me Policinë Bashkiake si dhe me Policinë e Rendit për organizimin e shërbimit pyjor dhe inspektimit të pyjeve dhe kullotave
- Harton dhe merr pjesë në hartimin e projekteve tekniko-ekonomike për zbatimin e masave për trajtimin e pyjeve dhe kullotave
- Harton projekt-akte dhe/ose projekt urdhëra që lidhen me mbrojtjen dhe menaxhimin e pyjeve dhe kullotave
- Harton dhe shqyrton dokumentacionin tekniko-ligjor për procedurat e dhënies në përdorim të pyjeve dhe kullotave sipas legjislacionit në fuqi
- Monitoron parqet dhe pyjet që administrojnë Bashkia nëpërmjet evidentimit të problematikave të hasura dhe raporton tek eprori përkatës
- Bashkëpunon me struktura të tjera institucionale duke dhënë informacionet e duhura ,në zbatim të strategjisë dhe planit kombëtar,për menaxhimin e mjedisit
- Adapton politikat kombëtare për mbrojtjen e mjedisit në nivelin e Bashkisë Pogradec duke përcaktuar objektivat e zhvillimit dhe indikatorët për matjen e realizimit të tyre në nivel lokal
- Bashkëpunon ngushtësisht me struktura të tjera institucionale për zbatimin e projekteve me karakter mjedisor ,për zbutjen e ndikimeve negative në mjedis në bashkëpunim me organizma të tjerë dhe komunitetin
- Bashkëpunon me struktura të tjera institucionale duke dhënë informacionet e duhura ,me qëllim përmirsimin e metodologjisë së trajtimit të mbetjeve në zbatim të strategjisë dhe planit kombëtar për menaxhimin e mbetjeve
- Bashkëpunon ngushtësisht me struktura të tjera politike bërëse dhe menaxhon punën për dhënien e informacioneve,mbi menaxhimin e mbetjeve me qëllim informimin aktiv të komunitetit
- Monitoron vendet e depozitimit të mbetjeve nëpërmjet evidentimit të problematikave të hasura dhe raporton tek eprori përkatës

- Organizon një regjistër të përditësuar të pikave me risk në depozitimin e mbetjeve urbane dhe të ngurta duke përcaktuar dhe kategoritë e riskut.